

ISSN 1127-8579

Pubblicato dal 04/02/2010

All'indirizzo <http://www.diritto.it/docs/28879-repubblica-del-kosovo-ligji-nr-03-l-002-p-r-plot-simin-dhe-ndryshimin-e-kodit-t-p-rkohsh-m-penal-t-kosov-s>

**Autori:**

**Repubblica del Kosovo: ligji nr.03/l-002 për plotësimin dhe ndryshimin e kodit të përkohshëm penal të Kosovës**

**LIGJI NR.03/L-002 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KODIT TË  
PËRKOHSHËM PENAL TË KOSOVËS**

**LIGJI Nr. 03/L-002**

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KODIT TË PËRKOHSHËM PENAL TË KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme dhe shtimin e efikasitetit të punës në Gjykata dhe Prokurori në Kosovë, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare,

Miraton

**LIGJ PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KODIT TË PËRKOHSHËM PENAL TË  
KOSOVËS**

**Neni 1**

Në titullin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe në tërë tekstin e këtij kodi fjalia Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës zëvendësohet me fjalinë Kodi Penal i Kosovës.

## **Neni 2**

### **Neni 66 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, plotësohet me një paragraf të ri si në vijim:**

3) Kur kryesi të ketë pranuar fajësinë në përputhje me kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të pranuar nga gjykata bazuar në nenin 6, (lidhur me nenin 308 A paragrafi 12) të Ligjit nr. 03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës nr. 2003/26 dhe marrëveshja mbi pranimin e fajësisë në formë të shkruar përmban klauzolën me të cilën parasheh zbutjen e dënimit, gjykata do të shqiptojë një dënim më të butë. Në rast të tillë, gjykata duhet të merr parasysh vështrimet e prokurorit, mbrojtësit, të akuzuarit dhe palës së dëmtuar sa i përket zbutjes së dënimit, dhe do të udhëzohet por jo detyrohet nga kufizimet e dhëna me nenin 67 të këtij Kodi.

## **Neni 3**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-002**

**6 Nëntor 2008**

**Shpallur me dekretin Nr. DL- 059- 2008, datë 27.11.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.**